



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 8.1.2025

Nr: 14

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

MIRATIMIN E FORMATIT DHE SPECIFIKIMEVE TË VULËS SË KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR, VULËS SË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT, VULËS SË KRYETARIT TË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT DHE VULËS REZERVË TË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT, PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 11 MAJ 2025

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, dhe nenit 99, pikat 1, shkronja “b”, dhe 2, nenit 103, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOS:

1. Miratimin e formateve dhe specifikimeve të vulave që do të përdorë administrata zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 11 maj 2025, si më poshtë:
 - a. vula e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi,
 - b. vula e Komisionit të Qendrës së Votimit, sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi,
 - c. vula e Kryetarit të Komisionit të Qendrës së Votimit, sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi,
 - ç. vula rezervë për Komisionin e Qendrës së Votimit, sipas lidhjes nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 8.1.2025 Nr: 14
Ora: 12:00



“Për miratimin e formatit dhe specifikimeve të vulës së KZAZ-së, KQV-së, Kryetarit të KQV-së dhe vulës rezervë për KQV-në, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025”

1. Zgjedhjet për Kuvendin të datës 11 maj 2025
2. Formati i Vulës: KZAZ



Legjenda:

3. Diametri = 38 mm
4. Stema e Republikës së Shqipërisë
5. tekst: Republika e Shqipërisë
6. tekst: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
7. Numri i Identifikimit: KZAZ-NR-XX.
8. tekst: Zgjedhjet për Kuvendin të datës 11 maj 2025

1. Zgjedhjet për Kuvendin të datës 11 maj 2025
2. Formati i Vulës: KQV



Legjenda:

3. Diametri = 38 mm
4. Stema e Republikës së Shqipërisë
5. tekst: Republika e Shqipërisë
6. tekst: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
7. Komisioni i Qendrës së Votimit
8. Numri i identifikimit: numri i qendrës përkatëse të votimit
9. tekst: Zgjedhjet për Kuvendin të datës 11 maj 2025

1. Zgjedhjet për Kuvendin të datës 11 maj 2025
2. Formati i Vulës: Kryetari i KQV-së



Legjenda:

3. Gjatësia = 50 mm
4. Gjerësia = 25 mm
5. Stema e Republikës së Shqipërisë
6. tekst: Republika e Shqipërisë
7. tekst: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
8. KRYETARI
9. Numër serial pesëshifror: XXXXX
10. tekst: Zgjedhjet për Kuvendin të datës 11 maj 2025

1. Zgjedhjet për Kuvendin të datës 11 maj 2025
2. Formati i Vulës: KQV - REZERVË



Legjenda:

3. Diametri = 38 mm
4. Stema e Republikës së Shqipërisë
5. tekst: Republika e Shqipërisë
6. tekst: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
7. Komisioni i Qendrës së Votimit
8. Numri i identifikimit: numri i qendrës përkatëse të votimit; tekst: REZERVË
9. tekst: Zgjedhjet për Kuvendin të datës 11 maj 2025